



**USAID** | **KOSOVO**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE

# PROGRAMI PËR TË DREJTAT PRONËSORE (PRP)

STUDIMI BAZË NË NIVELIN NACIONAL MBI TË  
DREJTAT PRONËSORE NË KOSOVË

QERSHOR 2015

Ky publikim është përgatitur për shqyrtim nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar.

Publikimi është përgatitur nga Tetra Tech.

Përgatitur për Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, Numri i Kontratës së USAID, AID-OAA-I-12-00032/AID-167-TO-14-00006 – Programi për të drejtat pronësore në Kosovë për Fuqizimin e të drejtave dhe burimeve (STARR), kontratë me vlerë të pacaktuar (IQC).

Kontaktet e Tetra Tech:

John (Jack) Keefe, Këshilltar i lartë teknik / Menaxher  
159 Bank Street, Suite 300  
Burlington, Vermont 05401  
Tel: (802) 495-0282  
Email: [jack.keefe@tetrattech.com](mailto:jack.keefe@tetrattech.com)

Don Cuizon, Menaxher i Projektit  
159 Bank Street, Suite 300  
Burlington, Vermont 05401  
Tel: (802) 495-0309  
Email: [don.cuizon@tetrattech.com](mailto:don.cuizon@tetrattech.com)

# PROGRAMI PËR TË DREJTAT PRONËSORE (PRP)

STUDIMI BAZË NË NIVELIN NACIONAL MBI TË  
DREJTAT PRONËSORE NË KOSOVË

QERSHOR 2015

## HEQJE E PËRGJEGJËSISË

Pikëpamjet e autorëve të shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

# PËRMBAJTJA

<b>PËRMBAJTJA</b> .....	<b>II</b>
<b>PËRBLLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	<b>III</b>
TË GJETURAT KRYESORE .....	III
TË GJETURAT SHITESË .....	IV
<b>1.0 HYRJE DHE HISTORIKU</b> .....	<b>1</b>
<b>2.0 METODOLOGJIA E HULUMTIMIT</b> .....	<b>2</b>
<b>3.0 REZULTATET E STUDIMIT</b> .....	<b>4</b>
3.1 NJOHURITË E QYTETARËVE RRETH TË DREJTAVE TË TYRE PRONËSORE.....	4
3.1.1 Të Drejtat Pronësore .....	4
3.1.2 Të Drejtat Në Trashëgimi .....	7
3.1.3 Transaksionet/Bartjet E Pasurisë Së Patundshme .....	10
3.1.4 Pronësia .....	12
3.2 BESIMET, QËNDRIMET DHE SJELLJET E QYTETARËVE RRETH TË DREJTAVE TË GRAVE MBI TRASHËGIMINË E PRONËS .....	17
3.3 KËNAQSHMËRIA ME SHËRBIMET GJYQËSORE NË ZGJIDHJEN E KONTESTEVE PRONËSORE....	35
<b>4.0 PËRFUNDIME</b> .....	<b>52</b>

# PËRBLLEDHJE EKZEKUTIVE

Në mënyrë që të krijohet një pasqyrë më e detajuar rreth qëndrimeve të qytetarëve për të drejtat pronësore në përgjithësi, dhe të drejtat e grave për të trashëguar pronë, TETRA TECH ka angazhuar UBO Consulting që të bëjë një studim në mënyrë që të fitojë njohuri për mendimet e qytetarëve rreth të drejtave pronësore, të drejtave të grave për të trashëguar, dhe për kënaqshmërinë e tyre me shërbimet e gjykatave në zgjidhjen e kontesteve pronësore. Për këtë studim është përdorur një mostër prej 1,250 të rriturish në Kosovë. Mostra ka përbajtur rreth tri nëngrupe: 850 shqiptarë, 200 serbë, dhe 200 pjesëtarë të komuniteteve tjera pakicë<sup>1</sup>. Ky hulumtim u zhvillua nga data 3 prill deri më 27 prill, 2015.

Për të krijuar një pasqyrë sa më të qartë për qëndrimet/sjelljet e njerëzve rreth të drejtave të grave për të trashëguar, UBO Consulting është angazhuar në mbajtjen e 15 fokus grupeve me qytetarë gjithandej Kosovës. Fokus grupet janë mbajtur me pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme si shqiptarë, serbë, romë, ashkali dhe egjiptianë. Gjithashtu, për të marrë informata specifike mbi kënaqshmërinë ndaj gjykatave, është mbajtur një fokus grup i veçantë me persona të cilët kanë pasur përvojë me raste pronësore dhe ato të trashëgimisë në pronë. Fokus grupet janë mbajtur mes datave 16 prill dhe 30 prill 2015.

## TË GJETURAT KRYESORE

- Nga të gjithë të anketuarit, 78% e tyre kanë deklaruar se në familjen e tyre nuk ka ndonjë femër të regjistruar si pronare të pronës. Nga të gjithë të anketuarit rreth 16% e tyre kanë deklaruar se një anëtare femër e familjes së tyre është e regjistruar si pronare e pronës, ndërsa numri i atyre të cilët kanë deklaruar se më shumë se një femër është e regjistruar si pronare është shumë i vogël (6%).
- Krahasuar me të anketuarit meshkuj, femrat kanë raportuar më shumë se e konsiderojnë si të tyren “pronën e krijuar gjatë martesës” (35% të femrave kundrejt 26.7% të meshkujve). Në anën tjetër, të anketuarit meshkuj besonin më shumë se atyre u përket “prona e trashëguar nga prindërit” (80% të meshkujve kundrejt 47% të femrave).
- Nga të gjithë të anketuarit, 59% kanë deklaruar se femrat duhet të trashëgojnë pronë nga familja e tyre e lindjes, krahasuar me 35% të atyre që kanë deklaruar se femrat nuk duhet të trashëgojnë pronë nga familja e tyre e lindjes. Nga të gjithë të anketuarit femra, 62% besojnë që femrat duhet të trashëgojnë, krahasuar me 55.6% e të anketuarve meshkuj të cilët besojnë se femrat duhet të trashëgojnë.
- Nga të gjithë të anketuarit, 62% nuk e mbanin mend ndonjë rast kur një vajzë ka trashëguar pronë, ndërsa 19% ju kujtohet një rast.
- Pjesa më e madhe e të anketuarve të përfshirë në këtë hulumtim besojnë se femrat tërhiqen apo heqin dorë nga realizimi i të drejtave të tyre në trashëgimi (87%). Vetëm 10% e tyre kanë deklaruar se femrat nuk heqin dorë/tërhiqen nga e drejta e tyre për të trashëguar pronë.

---

<sup>1</sup> Të tjera pakica përfshijnë anëtarët e komuniteteve: romë, ashkali, egjiptianë, turq, boshnjakë, kroatë, dhe goranë që jetojnë në Kosovë

## TË GJETURAT SHITESË

- Nga të gjithë të anketuarit, 23% kanë deklaruar se nuk e konsiderojnë veten si pronar të ndonjë pasurie të patundshme. Femrat, për dallim prej meshkujve, janë më shumë të mendimit se ato nuk posedojnë ndonjë pasuri të patundshme (29% femra kundrejt 17% meshkuj)
- Nuk ka pasur ndryshim statistikor të vlefshëm në mes të etniciteteve mbi njohurinë e tyre rreth dokumenteve të nevojshme për të bërë një bartje të pasurisë së patundshme ( $p=.093$ ).
- Ky studim paraqet një mungesë të përgjithshme të këtyre njohurive: 39.3% e të anketuarve shqiptarë, 42% e të anketuarve të minoriteteve jo-serbe dhe 23.9% e të anketuarve serb kanë deklaruar se ata posedojnë njohuri rreth dokumenteve të nevojshme për të realizuar një bartje të pasurisë të patundshme.
- Në regjionin e Ferizajt, njohuria rreth trashëgimisë dhe bartjes të pasurisë të patundshme ishte shumë e ulët krahasuar me regjionet tjera. Vetëm 6.2% kishin njohuri rreth dokumenteve për bartje të pasurisë së patundshme, krahasuar me 25% dhe 57% në regjionet tjera, dhe vetëm 15.6% e tyre për bartjen e trashëgimisë krahasuar me 27% dhe 57% me regjionet tjera. Në mënyrë të ngjashme, banorët e Ferizajt janë më pak të mendimit se femrat (nënat dhe vajzat/motrat) mund të fillojnë procedurën e bartjes së trashëgimisë (9.9%/4.2%) ose bartjen e një pasurie të patundshme (4.6%/1.1%). Qytetarët prej Gjakovës poashtu nuk ua njohin këtë të drejtë femrës (trashëgimi: 15.1%/7.2%; pasuri të patundshme: 6.2%/2.2%)
- Në përgjithësi, të anketuarit besojnë që baballarët janë ata anëtarë të familjes të cilët mund të bëjnë bartje të pasurisë së patundshme (blerje/shitje/dhënie me qira/hipotekë). Rreth 73% e të anketuarve besojnë që “babai” është i vetmi anëtar i familjes që mund të bëjë bartje të pasurisë së patundshme, 25% besojnë që “djali/vëllai” mund të bëjë këtë bartje, dhe vetëm 24% besojnë që “nëna” mund të bëjë një bartje të tillë. Këta 24% e të anketuarve të cilët konsideruan “nënë” si person i cili mund të bëjë një bartje ishin ata të cilët u përgjigjën saktë në pyetjen për t’i zgjedhur të gjithë anëtarët e familjes si të pranueshëm për të bërë një kërkesë të tillë.
- Në regjionin e Pejës 55.2% e të anketuarve, dhe në regjionin e Gjakovës 32.6% e të anketuarve deklaruan se vetëm një femër e familjes së tyre është e regjistruar si pronare, krahasuar me regjionet e tjera që variojnë mes 13.1% dhe 16.3%.
- Të anketuarit serbë (41%) raportuan më shumë se së paku një anëtar i familjes së tyre i regjistruar si pronar ishte femër krahasuar me të anketuarit shqiptarë (16%). Kjo mund të jetë indikacion se komuniteti shqiptar mund të ketë qëndrime më të forta kulturore kundër pronësisë së grave.
- Shumica e të anketuarve femra kanë deklaruar se ato nuk kanë njohuri rreth dokumenteve të nevojshme për të kërkuar trashëgiminë. Në mënyrë specifike, 66% e të anketuarve femra kanë deklaruar se nuk kanë njohuri për këto dokumente, krahasuar me 48% të anketuarve meshkuj të cilët kanë deklaruar të njëjtën gjë.
- Shqiptarët (41%) dhe minoritetet jo-serbe (39%) kanë pasur më shumë njohuri rreth dokumenteve të nevojshme për të kërkuar trashëgiminë, krahasuar me të anketuarit serbë (22%)

- Përderisa, përqindja e të anketuarve serb të cilët nuk mbanin mend ndonjë rast kur vajza ka trashëguar pronë në rrethinën e tyre ishte 17%, ajo e shqiptarëve ishte 65% dhe përqindja e grupeve minoritare jo-serbe ishte 39%.
- Përqindja e femrave të anketuara (34%) të cilat kanë deklaruar se kanë hequr dorë nga të drejtat e tyre për të trashëguar pronë konsiderohet si më e lartë se sa përqindja e meshkujve të cilët kanë deklaruar të njëjtën gjë (6%). Megjithatë, duhet përmendur që këto përqindje janë nga një grup më i vogël i atyre që kanë kaluar nëpër procedura të trashëgimisë (33% e femrave të anketuara dhe 36% e meshkujve).
- Në regjionin e Ferizajit, 98.4% e të anketuarve pajtohen që trashëgimia duhet të ndahet e barabartë mes djemve dhe vajzave dhe rreth 84.5% e tyre besojnë që femrat duhet të trashëgojnë prej familjes së tyre të lindjes; ndërsa në Pejë vetëm 47.5% e tyre pajtohen që femrat dhe meshkujt duhet të kenë të drejta të barabarta në trashëgimi dhe vetëm 29.2% pajtohen se femrat duhet të trashëgojnë nga familjet e tyre të lindjes.
- Në përgjithësi, nënat konsiderohen si mbështetëset më të mëdha të trashëgimisë së femrave, pasuar nga baballarët. Kjo gjë varet nga regjioni. Në Gjakovë, vetëm 3% e të anketuarve deklaruan se baballarët janë mbështetës, ndërsa në Ferizaj rreth 72.4%. Në Mitrovicë, 40.2% deklaruan që baballarët janë shumë mbështetës, ndërsa në Prizren vetëm 11% e tyre. Regjionet e tjera sillen prej 25% në 39%. Në Ferizaj njerëzit besojnë më shumë se nënat janë shumë mbështetëse (87.4%) se sa në Gjakovë (6.6%). Regjionet e tjera sillen mes 26% dhe 64.7%.
- Nga të gjithë të anketuarit, 57% kanë deklaruar se familja e tyre e lindjes nuk ka kaluar asnjëherë nëpër procesin e ndarjes së trashëgimisë.
- Vetëm 5% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë dosje në gjykata rreth çështjeve të trashëgimisë. Prej tyre 2.2% janë femra dhe 6.9% meshkuj.
- Shumica e të anketuarve femra (67%) të cilat janë të përfshira në raste pronësie (nga vetëm 2% e të anketuarve femra që kanë thënë që janë të përfshira në raste pronësie) deklaruan që një anëtar mashkull i familjes së tyre e kishte filluar procedurën ligjore në gjykatë.
- Vetëm 22% e të anketuarve të cilët kishin raste pronësie në gjykatë ishin të kënaqur me kohën e procedimit të rastit.

# 1.0 HYRJE DHE HISTORIKU

Përkundër një progresi të madh në dekadën e fundit, Kosova ende ballafaqohet me sfidën globale të përmirësimit të barazisë gjinore. Kjo përfshinë qasjen jo të barabartë në burime ekonomike dhe mjedisore nga femrat<sup>2</sup>. Sundimi i ligjit në Kosovë karakterizohet me të drejta pronësore të definuara dhe të zbatuara dobët, sidomos të drejtat pronësore të femrave dhe grupeve minoritare. Mungesa e një aplikimi efikas të të drejtave pronësore e dobëson qeverisjen demokratike, negativisht ndikon në të drejtat e njeriut, shfuqizon femrat, dhe pengon rritjen e qëndrueshme ekonomike. Në vitin 2014, femrat posedonin vetëm 15.2% të pasurisë së patundshme në Kosovë, duke përfshirë edhe tokën<sup>3</sup>.

Tetra Tech është përzgjedhur nga USAID me një kontratë për implementimin e Programit për të Drejtat Pronësore (PRP) në Kosovë. Synimi i Programit për të Drejtat Pronësore është përmirësimi i aplikimit të të drejtave pronësore në Kosovë, forcimi i sundimit të ligjit dhe rritja ekonomike dhe e investimeve.

PRP mbështetë objektivat e mëposhtme:

- Koordinim më të mirë në përcaktimin e politikave me prioritetet;
- Përmirësim të procedurave gjyqësore në lidhje me kërkesat pronësore;
- Rritje të mundësive që gratë të ushtrojnë të drejtat e tyre pronësore në praktikë; dhe
- Qasje më të mirë në informata dhe në të kuptuarit e të drejtës pronësore.

PRP ka ngarkuar UBO Consulting për kryerjen e një hulumtimi për të mbledhur informacione të ndërlidhura me indikatorët. Ky hulumtim ka përfshirë:

- kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimet gjyqësore në zgjidhjen e problemeve pronësore,
- qëndrimet/sjelljet e tyre rreth të drejtave të grave për të trashëguar pronë dhe për t'u përfshirë në aktivitete ekonomike, dhe
- njohuritë e qytetarëve rreth të drejtave pronësore.

---

<sup>2</sup> Strategjia për Barazi Gjinore 2014 – 2017, UNDP Kosovo, gusht 2014

<sup>3</sup> Raport i Agjencionit Kadastral për pronësi të pronës në Kosovë, Mars 2014




## 2.0 METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Për këtë studim është përdorur një metodologji e kombinuar e hulumtimit kualitativ dhe kuantitativ. Ky hulumtim është realizuar përmes:

- Hulumtimit sasiorë prej 1,250 të anketuarve;
- 15 fokus grupeve me kategori të ndryshme të qytetarëve.

Anketat ballë-për-ballë janë realizuar më 1,250 të rritur (mosha 18+). Mostra ka qenë e ndarë në tri nëngrupe: 850 shqiptarë, 200 serbë dhe 200 pjesëtarë të minoriteteve tjera. Margjina e gabimit për të gjithë mostrën është  $\pm 3\%$ .

**Figura 1. Ndarja e mostrës sipas gjinisë**



Grafiku më lart tregon ndarjen e tri nëngrupeve të mostrës sipas gjinisë dhe etnicitetit. Mosha mesatare e 1,250 të anketuarve në këtë studim ka qenë 38.56 vjet, me rangun e të anketuarve mes moshës 18 dhe 84 vjeç. Ndërkaq, mesatarja e anëtarëve të familjes të të anketuarve ka qenë 5.8, duke ranguar prej 1 deri në 23.

Puna në terren e këtij hulumtimi është kryer gjatë periudhës 3 prill dhe 27 prill, 2015.

Përveç pyetësorit sasiorë, janë shfrytëzuar edhe sesionet e fokus grupeve për nxjerrjen e rezultateve sasiorë rreth perceptimeve të qytetarëve në lidhje me këto çështje:

- njohuritë e qytetarëve rreth të drejtave pronësore,
- qëndrimet/sjelljet e tyre rreth të drejtave të grave për të trashëguar pronë dhe për t'u përfshirë në aktivitete ekonomike, dhe
- kënaqshërinë e qytetarëve më shërbimet gjyqësore në zgjidhjen e problemeve pronësore (vetëm gjatë sesioneve të fokus grupeve me përdoruesit e gjykatave)

Diskutimet në fokus grupe janë mbajtur më qytetarët shqiptarë dhe serbë (të ndara në gjini), meshkuj të komuniteteve romë, ashkli dhe egjiptianë, dhe me përdoruesit e gjykatave. Shpërndarja e fokus grupeve është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

**Figura 2. Shpërndarja e seancave të fokus grupeve**

Target grupet	Seanca e meshkujve	Seanca e femrave	Totali
Qytetarët shqiptarë	4	4	8
Qytetarët serbë	2	2	4
Qytetarët romë, ashkali dhe egjiptianë	1	0	1
Përdoruesit e gjykatës	1	1	2
<b>Totali</b>	<b>8</b>	<b>7</b>	<b>15</b>

Sa i përket dy fokus grupeve me përdoruesit e shërbimeve të gjykatave, UBO Consulting ka përdorur informatat nga pyetësori për të targetuar dhe rekrutuar personat të cilët kanë pasur përvojë me raste gjyqësore rreth pronës/trashëgimisë në të kaluarën. Ndërsa për 13 fokus grupet tjera, janë përdorur pyetje ekzaminuese për t'u siguruar që pjesëmarrësit e rekrutuar nuk kanë pasur përvojë paraprake me raste gjyqësore në lidhje me pronësinë/trashëgiminë.

Fokus grupet janë mbajtur nga 16 deri më 30 prill 2015.

# 3.0 REZULTATET E STUDIMIT

## 3.1 NJOHURITË E QYTETARËVE RRETH TË DREJTAVE TË TYRE PRONËSORE

### 3.1.1 TË DREJTAT PRONËSORE

Të anketuarit janë pyetur nëse ata posedojnë pronë, dhe çfarë do të thotë prona për ta. Nga të gjithë të anketuarit 23% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk e konsiderojnë veten si pronar të ndonjë pasurie të patundshme. Femrat kishin tendencë të besonin më shumë se ato nuk posedojnë ndonjë pronë të patundshme (29% të femrave kundrejt 17% të meshkujve).

Tri përgjigjet kryesore në pyetjen se çfarë nënkuptoni me “të drejtat pronësore në pronën tuaj” ishin: "të posedoni dhe ta shfrytëzoni pronën si rezultat i vendimit gjyqësor që iu njeh të drejtën e pronës" (58%), "të posedoni dhe ta shfrytëzoni pronën e cila i përket familjes edhe pse nuk është bërë ndarja e trashëgimisë" (50%), dhe "e posedoni dhe e shfrytëzoni pronën të cilën ju apo paraardhësit e juaj e keni blerë në bazë të një kontrate të legalizuar apo noterizuar (kontrata formale)" (49%). Nuk ka pasur ndryshime të mëdha mes përgjigjeve të femrave dhe meshkujve në këtë aspekt. Në Ferizaj, mbi 94% e të anketuarve kanë zgjedhur opsionin me vendimin gjyqësor; kjo ka qenë përqindje më e lartë se sa në regjionet e tjera dhe mund të nënkuptojë se qytetarët kanë marrëdhënie të ndryshme me gjykatat.

Të anketuarit e shohin pronën e familjes dhe llojeve tjera të pronës ndryshe nga njëra-tjetra. Rëndësia e regjistrimit/formalizimit të pronës së blerë apo prona të rregulluara nga gjykatat është e njohur për të anketuarit, por shumica e të anketuarve besojnë se ata kanë të drejta pronësore në pronën e familjes edhe pa proces formal gjyqësor.

**Figura 3. A mund ta përshkruani, çka kuptoni me të drejtat pronësore mbi pronën tuaj?**




Këtu kemi disa ndryshime mes etniciteteve. Të anketuarit serbë (25%) kishin tendencë më shumë se sa të anketuarit shqiptarë (11%) t'i definonin të drejtat pronësore si "të poseduarit dhe të shfrytëzuarit e pronës edhe pse nuk kanë ndonjë certifikatë/posedim", ndërsa të anketuarit shqiptarë kishin tendencë më të madhe të deklaroinin se e drejta pronësore do të thotë "të posedosh dhe të shfrytëzosh pronën si rezultat i një vendimi gjyqësor i cili të njeh të drejtën pronësore" (26% të shqiptarëve kundrejt 19% të serbëve).

Shumica e të anketuarve (74%) deklaruan se vetëm një anëtar i familjes së tyre është i regjistruar si pronar i pronës, ndërsa 21% deklaruan se dy apo më shumë anëtarë të familjes janë të regjistruar si pronarë të pronës. Në anën tjetër, rreth 5% thanë se asnjë anëtar i familjes së tyre nuk është i regjistruar si pronar aktual i pronës.

E rëndësishme është se termi "anëtar i familjes" nuk është definuar, andaj mund të jetë interpretuar si person i gjallë apo i vdekur.


**Figura 4. Sa anëtarë të familjes janë të regjistruar si pronar të pronës?**



Numri i familjarëve femra të regjistruara si pronare të pronës është shumë i vogël. Nga të gjithë të anketuarit 78% kanë deklaruar se nuk kanë ndonjë femër në familjen e tyre të regjistruar si pronare të pronës. Ndërsa 16% e tyre kanë deklaruar se vetëm një femër në familjen e tyre është e regjistruar si pronare, ndërsa numri i të anketuarve të cilët kanë deklaruar se më shumë se një femër është e regjistruar si pronare e pronës është shumë i vogël (6%). Të anketuarit serbë (41%) kishin tendencë të deklaroinin më shumë se së paku një femër është e regjistruar si pronare, krahasuar me të anketuarit shqiptarë (16%).


Në regjionin e Pejës, 55.2% dhe në regjionin e Gjakovës 32.6% e të anketuarve deklaruan se një anëtare femër e familjes së tyre ishte e regjistruar si pronare e pronës krahasuar me vetëm 13.1% dhe 16.3% në regjionet tjera.

**Figura 5. Sa prej anëtarëve të familjes të regjistruar si pronarë të pronës janë femra?**



Në 90% të rasteve, ku vetëm një anëtar i familjes është regjistruar si i vetmi pronar i pronës, ai anëtar është mashkull. Ndërkaq, në rastet ku dy anëtarë të familjes janë të regjistruar si pronarë, 48% e tyre janë femra dhe 52% janë meshkuj. Nga kjo mund të përfundojmë se 13% e gjithë pasurisë është e regjistruar në mënyrë të përbashkët (bashkëpronësi).

**Figura 6. Sa prej anëtarëve të familjes të regjistruar si pronarë të pronës janë femra? – Të shpërndara në gjini**



### 3.1.2 TË DREJTAT NË TRASHËGIMI

Në pyetjen se cilët familjarë mund të bëjnë kërkesë për procedurën e ndarjes së trashëgimisë, vetëm 24% e të anketuarve u përgjigjën drejtë.<sup>4</sup> Shumica e të anketuarve besonin se “babai” (69%) mund të bënte një kërkesë të tillë, pasuar nga “djali/vëllai” (45%) dhe “nëna” (35%). Që të dyja gjinitë, meshkujt dhe femrat, besonin kryesisht se meshkujt në familjen e tyre mund të iniciojnë këto procedura.

Mbi 95% e të anketuarve në regjionin e Pejës dhe mbi 93% në regjionin e Gjakovës besonin se babai mund të bënte kërkesë për trashëgimi, krahasuar me një përqindje më të ulët në regjionet tjera. Në regjionin e Ferizajit, vetëm 4% e të anketuarve besonin se vajza/motra mund të bëjë një kërkesë të tillë, dhe vetëm 10% që nëna mund të bëjë një kërkesë të tillë. Këto përqindje të ulëta mund të nënkuptojnë një situatë më të përkeqësuar për femrat dhe të drejtat e tyre për të trashëguar në këtë regjion. Nuk ka pasur ndryshime të mëdha mes grup moshave të ndryshme.

Në pyetjen se cila pronë duhet t’u takojë të dy bashkëshortëve (gruas dhe burrit), rreth 90% e të anketuarve thanë se “prona e krijuar gjatë martesës” duhet t’u takojë të dy bashkëshortëve. Më pak të anketuar besonin se “prona e trashëguar nga prindërit e të dy palëve”(31%) duhet t’u takojë të dy bashkëshortëve, e edhe më pak thanë se “prona e fituar nga të dy bashkëshortët para martesës” (24%) duhet t’u takojë të dy bashkëshortëve. Vetëm 10% e të anketuarve besonin se “prona jo e ndarë e prindërve/fëmijëve nga të dy anët” duhet t’u takojë të dy bashkëshortëve.

**Figura 7. Sipas mendimit tuaj, cila pronë duhet t’u takojë të dy partnerëve (burrit dhe gruas)?**



Shumica e të dy palëve femra (91%) dhe meshkuj (89%) deklaruan se prona e krijuar gjatë martesës duhet t’u takojë të dy bashkëshortëve. Në këtë aspekt ka pasur ndryshime mes të anketuarve të martuar dhe të pamartuar, ku 92% e të anketuarve të martuar ishin të mendimit se prona e krijuar gjatë martesës duhet t’u takojë të dy partnerëve, krahasuar me 86% e të anketuarve të pamartuar të cilët kanë deklaruar të njejtën gjë.

<sup>4</sup> Grup përgjigjesh: Babai, nëna, vajza/motra, djali/vëllau, burri/dhëndëri, gruaja/nusja, dhe/ose ndonjë i rritur që ka lidhje me familjen

Kjo vë në dukje ndryshimin mes përshtypjes së pronës së blerë dhe të trashëguar. Ky fakt është sqaruar gjatë seancave të fokus grupeve. Përderisa, shumica e pjesëmarrësve në fokus grupe pajtoheshin se femrat duhet të trashëgojnë gjysmën e pronës nga burrat e tyre, disa të tjerë deklarorin se gruaja ka të drejtë të trashëgojë vetëm pronën e cila është krijuar pasi ajo është martuar, ndërsa nuk ka të drejta mbi pronën që e ka trashëguar burri më parë.


Pjesëmarrësit nga Prishtina kishin më së shumti njohuri rreth këtyre çështjeve. Pjesëmarrësit nga rajionet tjera nuk kishin shumë informacion se si e përcakton ligji këtë çështje.

**FOKUS GRUPI NË PEJË**

*“Unë nuk e konsideroj asnjë pronë të burrit tim si timen.”*


**PJESËMARRËSE FEMËR**

**Figura 8. A e dini se cilët anëtarë të familjes mund të shtrojnë një kërkesë për ndarje të trashëgimisë?**



Të anketuarit janë pyetur nëse kishin njohuri rreth dokumenteve të nevojshme për të kërkuar trashëgimi. Rreth 40% e tyre deklaruan se ata kanë njohuri për këto dokumente, ndërsa 57% nuk kishin njohuri rreth tyre.

**Figura 9. A keni njohuri për dokumentet që nevojiten për të kërkuar ndarjen e trashëgimisë?**




Të anketuarat femra përbëjnë shumicën e atyre që deklaruan se nuk kishin njohuri rreth dokumenteve të nevojshme për kërkesë të trashëgimisë. Përkatësisht, 66% e femrave kanë deklaruar se ato nuk kanë njohuri, krahasuar me 48% meshkuj të cilët kanë deklaruar të njëjtën. Sa i përket etnicitetit, të anketuarit shqiptarë (41%) dhe minoritetet jo-serbe (39%) ishin më shumë të njohur me këto dokumente sesa të anketuarit serbë (22%).

Sa i përket grup moshave, nuk ka pasur ndryshime të dukshme, edhe pse pothuajse 70% e grup moshës 18-24 nuk kishin njohuri, përballë 58% deri 46% të grup moshave tjera.

Njohuritë në regjionin e Ferizajit kanë qenë jashtëzakonisht të vogla; vetëm 6.2% e të anketuarve kishin njohuri rreth dokumenteve të nevojshme për kërkesën e trashëgimisë.

**Figura 10. A keni njohuri për dokumentet që nevojiten për të kërkuar ndarjen e trashëgimisë? – Të shpërndara në gjini**




Në pyetjen se ku duhet bërë kërkesa për trashëgimi, shumica e të anketuarve besonin se këto kërkesa mund të bëhen në “gjykatë themelore” (53%), ose në “komunë/zyre kadastrale” (52%). Vetëm 43% e të anketuarve kishin njohuri se kërkesa për trashëgimi mund të bëhej përmes noterit. Përderisa meshkujt



dhe femrat ishin të barabartë në përgjigjet tjera, vetëm 36% e femrave e dinin se një kërkesë e tillë mund të bëhej përmes noterit, krahasuar me 50% e meshkujve.

Në të njëjtën mënyrë, serbët (13%) kishin më pak tendencë se sa shqiptarët (24%) dhe minoritetet e tjera (27%) ta identifikonin noterin si opsion në këtë çështje. Në këtë aspekt nuk ka pasur ndryshime të mëdha mes grup moshave, përveç të atyre mbi 65 vjeç të cilët kishin më pak tendencë (33%) të besonin se kërkesat për trashëgimi duhet të bëheshin tek noteri, krahasuar me grupet tjera (mes 41% dhe 50%).

**Figura 11. A e dini ku duhet të shtroni një kërkesë për trashëgimi?**



Kjo gjithashtu mbështetet nga të gjeturat gjatë diskutimeve në fokus grupe, pasi që shumica e meshkujve dhe femrave pjesëmarrëse ishin të mendimit se numri i femrave të cilat trashëgojnë pronë të patundshme në Kosovë është shumë i vogël krahasuar me meshkujt. Arsyet kryesore për këtë, sipas disa pjesëmarrësve të fokus grupeve, ndërlidhen me traditat dhe zakonet, pasi që femrat shpesh as nuk i kërkojnë të drejtat e tyre trashëgimore pasi që “ato nuk dëshirojnë t’i shkatërrojnë marrëdhëniet me familje dhe të paragjykojnë nga shoqëria”.


### 3.1.3 TRANSAKSIONET/BARTJET E PASURISË SË PATUNDSHME

Rezultatet e studimit kanë treguar se sikurse me procedurat e trashëgimisë, në përgjithësi bartjet e pasurisë të patundshme (blerje/shitje/dhëni me qira/hipotekë) konsiderohen si e drejtë ekskluzive e “babait.” Nga të gjithë të anketuarit, 73% e të anketuarve besonin se “babai” është i vetmi familjar i cili mund të bëjë një bartje të pasurisë të patundshme, 25% besonin se “djali/vëllai”, dhe vetëm 24% besonin se “nëna” mund të bëjë një bartje të tillë.

Nga të gjithë të anketuarit, 24% kanë përmendur “nënë” si një person që mund të bëjë një bartje të pasurisë të patundshme, ishin ata të anketuar të cilët u përgjigjën drejt në pyetje duke zgjedhur secilin anëtar të familjes si të pranueshëm për të bërë një kërkesë të tillë. Në këtë aspekt nuk ka pasur ndryshime mes grup moshave.


Sipas regjionit, përsëri, Peja dhe Gjakova kishin rreth 90% të të anketuarve të cilët zgjedhën vetëm babain, ndërsa në të tjera regjione kjo përqindje sillet rreth 45% deri në 85%. Përfundimisht, shqiptarët (44%) kishin më shumë tendencë të zgjidhnin babain në këtë aspekt sesa serbët (19%).

**Figura 12. A e dini se cilët anëtarë të familjes mund të realizojnë bartje të pasurisë së patundshme (blerje/shitje/dhëni me qira/hipotekë)?**



Nga të gjithë të anketuarit, 39% deklaruan se ata kishin njohuri rreth dokumenteve që kërkohen për të bërë një bartje të pasurisë së patundshme (blerje/shitje/dhënie me qira/hipotekë), ndërsa 58% e tyre deklaruan se ata nuk kanë njohuri rreth këtyre dokumenteve.

**Figura 13. A keni njohuri për dokumentet e nevojshme për të kryer një bartje të pasurisë së patundshme (blerje/shitje/dhënie me qira/hipotekë)?**




Të anketuarat femra kanë treguar të kenë më pak njohuri rreth bartjes së pasurisë së patundshme. Vetëm 29% e tyre kanë deklaruar se kanë njohuri rreth dokumenteve që kërkohen për të bërë një bartje të pasurisë së patundshme, krahasuar me 48% e të anketuarve meshkuj.

Në këtë aspekt ka pasur ndryshime të mëdha mes regjioneve. Vetëm, 6.2% e të anketuarve nga Ferizaj kanë deklaruar se kanë njohuri se cilat dokumente nevojiten, ndërsa në regjionet e tjera përqindja sillet

prej 25% (Gjakova) deri në 57% (Prizren). Kjo mund të ketë lidhje me ndarjen urbane/rurale ose mund të kërkojnë edhe më shumë hollësi, sidomos pasi planet e komunikimit janë hartuar.

Nuk ka pasur ndryshime mes grup moshave në këtë aspekt, edhe pse më të rinjtë (18-24) dhe më të vjetërit (65+) në përqindje më të madhe deklaruan se nuk kanë njohuri të mjaftueshme (65%) sesa grup moshat tjera (rreth 55%).

**Figura 14. A keni njohuri për dokumentet e nevojshme për të kryer një bartje të pasurisë së patundshme (blerje/shitje/dhënie me qira/hipotekë)? – Të shpërndara në gjini**




Me ndarjen e rezultateve sipas etniciteve, rezultatet tregojnë se të anketuarit e etnicitetit shqiptarë (39%) dhe atyre të minoriteteve jo-serbe (42%) besonin më shumë se ata kishin njohuri rreth dokumenteve të nevojshme për bartje të pronës së patundshme krahasuar me të anketuarit serbë (23.9%).

### 3.1.4 PRONËSIA

Kur të anketuarit u pyetën nëse ata e konsiderojnë veten si pronar të ndonjë prone të patundshme, mbi 71% e të anketuarve u përgjigjën se ata e konsiderojnë veten pronar të “shtëpisë/banesës”, 50% pronar të “tokës”, 4% pronar të “ndërtesës”, dhe 23% deklaruan se nuk kanë ndonjë pronësi mbi ndonjë pasuri të patundshme. Përsëri, ky ka qenë një vetëpërceptim i pronësisë; shiko më lart për konceptet më të zakonshme të “pronësisë”, mes grupeve të ndryshme.


**Figura 15. A mund të na tregoni se a e konsideroni veten si pronar të ndonjë prone të paluajtshme?**



Të anketuarit meshkuj kishin tendencë më shumë të deklaroheshin se ata ishin pronar të ndonjë pasurie të patundshme se sa të anketuarat femra, edhe pse ndryshimi ishte më i madh në pyetjen nëse prona ishte e regjistruar. Ashtu siç pritej, të anketuarit më të rinj deklaruan më shumë se ata nuk posedojnë ndonjë pronë (35.8% e 18-24 vjeç) sesa grup moshat tjera (mes 13.2% dhe 26.7%).


Banorët e regjionit të Prizrenit posedonin më pak pronë sesa banorët e regjioneve tjera (44.8% përballë 8.7% dhe 27.7%).

**Figura 16. A mund të na tregoni se a e konsideroni veten si pronar të ndonjë prone të paluajtshme? - Të shpërndara në gjini**



Në pyetjen se cilën pronë e konsideroni tuajën, 64% e të anketuarve deklaruan se ata e konsiderojnë, “pronën e trashëguar nga prindërit” si të tyre, 45% e tyre e konsiderojnë "pronën e krijuar/fituar vet" si të tyre, 41% e konsiderojnë “pronën e krijuar gjatë martesës” si të tyre, dhe 28% e konsiderojnë “pronën e pandarë të prindërve, vëllezërve/motrave ose të farefisit më të largët” si pronë të tyre.

**Figura 17. Cilin lloj të pronës ju e konsideroni si tuajën?**




Në krahasim me të anketuarit meshkuj, femrat kanë qenë më shumë të mendimit se “prona e krijuar gjatë martesës” ishte e tyre (50% e femrave përballë 32% e meshkujve). Në anën tjetër, të anketuarit meshkuj deklaruan se "prona e trashëguar nga prindërit" u përket atyre (80% përballë 47% femra).

Në Prishtinë dhe Pejë, të anketuarit kishin më shumë tendencë të posedonin pronën e krijuar gjatë martesës (60.1% dhe 73%) sesa regjionet tjera (mes 19.4% dhe 46.8%). Kjo mund të ndodh sepse është më e lehtë ose më e pranueshme të blihet prona e patundshme në vendet urbane sesa në ato rurale.

Në regjionin e Ferizajit, vetëm 25.4% e të anketuarve kanë identifikuar pronën e trashëguar si të tyre, krahasuar me 49.2% dhe 71.1% në vendet tjera.


**Figura 18. Cilin lloj të pronës ju e konsideroni si tuajën? – Të shpërndara në gjini**



Kur të anketuarit u pyetën cila pronë ishte e regjistruar në emrin e tyre, përqindja ishte dukshëm më e vogël krahasuar me vetëpërceptimin lidhur me pronësinë. Për shembull, vetëm 41% e atyre që kishin deklaruar se e konsiderojnë të tyre “pronën e krijuar/fituar vet” e kishin të regjistruar këtë pronë në emrin e tyre, dhe vetëm 29% deklaruan të njëjtën gjë për “pronën e krijuar gjatë martesës”.


Një numër edhe më i vogël i të anketuarve deklaruan se “prona e trashëguar nga prindërit” (24%), dhe “prona e pandarë e prindërve, vëllezërve/motrave ose të farefisit më të largët” (13%) ishte e regjistruar në emrin e tyre. Kjo edhe një herë tregon se të anketuarit nuk tentojnë të formalizojnë pronësinë mbi pronën e trashëguar pasi që si të tillë e konsiderojnë më të sigurt.

**Figura 19. A është prona e regjistruar në emrin tuaj?**




Gjatë ndarjes sipas gjinisë, të dhënat e studimit tregojnë se meshkujt kishin më shumë tendencë të deklarorin se prona të cilën ata e konsiderojnë të tyre është e regjistruar në emrin e tyre.

**Figura 20. Cilin lloj të pronës ju e konsideroni si tuajën? A është prona e regjistruar në emrin tuaj? [Të anketuarat Femra]**




**Figura 21. Cilin lloj të pronës ju e konsideroni si tuajën? A është prona e regjistruar në emrin tuaj?  
[Të anketuarit Meshkuj]**



Përdindja e respondentëve meshkuj që kanë pronë të regjistruar në emrin e tyre është më e lartë sesa përqindja e femrave: 79% meshkuj versus 19% femra. Kjo sidomos e theksuar kur ka të bëjë me pronën e trashëguar: 3.8% e femrave versus 21% e meshkujve.


Kjo statistikë është marrë nga të dhënat e Qeverisë. Sipas Agjencisë Kadastral, në Kosovë femrat posedonin vetëm 15.2% të pronës në vitin 2014, përfshirë këtu edhe tokën.<sup>5</sup>

**Figura 22. Prona e regjistruar – Ndarja sipas gjinisë**



<sup>5</sup> Raport i Agjencionit Kadastral për pronësi të pronës në Kosovë, Mars 2014


**Figura 23. A është prona e regjistruar në emrin tuaj? – Ndarja sipas gjinisë (n=1,250)**



### 3.2 BESIMET, QËNDRIMET DHE SJELLJET E QYTETARËVE RRETH TË DREJTAVE TË GRAVE MBI TRASHËGIMINË E PRONËS

Në pyetjen se kush siguron të ardhura në familjen tuaj, shumica e të anketuarve kanë identifikuar një familjar mashkull. Përgjigjja më e shpeshtë ka qenë "babai" (64%), pasuar nga "djali/vëllai" (42%), dhe "burri/dhëndri" (18%). Përgjigjet se të ardhurat e familjes sigurohen nga "nëna" (17%) dhe "vajza/motra" (12%) ishin më pak të zakonshme mes të anketuarve. Grup moshë e të anketuarve 18-24 vjeç identifikuan më shumë babain në këtë aspekt (86.4%). Femrat, në anën tjetër, identifikuan babain më pak sesa meshkujt në pyetjen se kush siguron të ardhura në familje (56.8% e femrave u përgjigjën "babai" në këtë pyetje përballë 71.9% e meshkujve).


**Figura 24. A mund të na tregoni kush kontribuon më të ardhura në ekonominë tuaj familjare?**





Një përqindje më e lartë e të anketuarve serbë deklaruan se femrat e familjes së tyre kontribuojnë në të ardhurat e familjes së tyre, krahasuar me të anketuarit shqiptarë dhe minoriteteve të tjerë jo-serbe. Një përqindje më e lartë e banorëve të Pejës (41.9%) kanë identifikuar nënën si kontribuuese në ekonominë familjare, krahasuar me regjionet tjera.

**Figura 25. A mund të na tregoni kush kontribuon me të ardhura në ekonomin tuaj familjare? – Ndarja sipas etniciteteve**




Sipas shumicës së të anketuarve, kontribuuesi më i madh në krijimin e pasurisë së familjes ishte “babai” (64%). Vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve besonin se “burri/dhëndri” (14%) dhe “djali/vëllai” (10%) kontribuojnë në krijimin e pasurisë. Përsëri, grup moshë mes 18-24 vjeç kishte më shumë tendencë të identifikonin babain (85.9%), dhe femrat kishin më pak tendencë të përgjigjeshin “babai” sesa meshkujt në këtë pyetje (56.1% përballë 72.7%).

Përveç kësaj, më shumë se gjysma e të anketuarve deklaruan se personi më me autoritet në vendimmarrjet e familjes është “babai” (54%), ku grupi i të anketuarve më të rinj identifikuan babain më së shumti (2.5%). Përsëri vetëm 46% e femrave identifikuan “babain” kundrejt 62.3% e meshkujve. Vetëm 19% e të anketuarve deklaruan se vendimet e tilla merren “bashkërisht”; kjo statistikë ishte e barabartë për meshkuj dhe femra.

Asnjë i anketuar nga Peja dhe Gjakova nuk deklaruan se vendimet në familje merren bashkërisht, krahasuar me mesataren 19%. Në Gjakovë, në fakt, 92% deklaruan se babai i merr këto vendime.


Në anën tjetër, “nëna” (4%) dhe “gruaja/reja” (1%) konsideroheshin si më me autoritet në vendimmarrje nga një numër shumë i vogël i të anketuarve, më së shumti në Prizren (5.6%) dhe Prishtinë (5.8%).

**Figura 26. Ju lutemi a mund të na tregoni se kush në shtëpinë tuaj vendos në lidhje me vendimet e rëndësishme që përfshinë juve dhe anëtarët e tjerë të familjes?**




Shumica e të anketuarve besonin se femrat dhe meshkujt duhet të kenë të drejta të barabarta në posedimin e pronës. Rezultatet kanë treguar se 85% e të anketuarve kanë deklaruar se femrat dhe meshkujt duhet të kenë të drejta të barabarta, ndërsa vetëm 13% kanë deklaruar të kundërtën. Kjo ishte mjaftë e krahasueshme mes të gjitha grup moshave, etniciteteve dhe regjioneve, megjithëse Ferizaj pati shkallën më të lartë të pajtimit (98.4%).

**Figura 27. A besoni se gratë dhe burrat duhet të kenë të drejta të barabarta në pronësi të pronës?**




Në ndarjen sipas gjinisë, një përqindje pak më e lartë e të anketuarve meshkuj (17%) nuk u pajtuan me idenë se meshkujt dhe femrat duhet të kenë të drejta të barabarta në posedimin e pronës përballë 10% të femrave të cilat thanë të njëjtën gjë.

**Figura 28. A besoni se gratë dhe burrat duhet të kenë të drejta të barabarta në pronësi të pronës? – Ndarja sipas gjinisë**




Kur të anketuarit u pyetën nëse djemtë dhe vajzat duhet të trashëgojnë në mënyrë të barabartë, 80% e tyre besonin se ata duhet të trashëgojnë në mënyrë të barabartë, ndërsa vetëm 18% besonin të kundërtën. Kur përgjigjet u ndanë sipas gjinisë, të anketuarat femra besonin më shumë sesa ata meshkuj, se djemtë dhe vajzat duhet të trashëgojnë në mënyrë të barabartë.

**Figura 29. A besoni se djemtë dhe vajzat duhet të trashëgojnë në mënyrë të barabartë? – Ndarja sipas gjinisë**




Siç shihet nga figura e mëposhtme, nuk ka pasur ndryshime të dukshme në këtë aspekt mes të anketuarve të etniciteteve dhe grup moshave të ndryshme. Mirëpo, ka pasur ndryshime në regjionet e ndryshme. Në regjionin e Ferizajit, 98.4% e të anketuarve pajtoheshin se trashëgimia duhet të ndahet në mënyrë të barabartë, ndërsa në Pejë vetëm 47.5% e tyre u pajtuan me këtë fakt. Regjionet e tjera ishin mes 73 dhe 86%.

**Figura 30. A besoni se gratë dhe burrat duhet të kenë të drejta të barabarta në pronësi të pronës?**



Ndërkohë, 59% e të anketuarve deklaruan se femrat duhet të trashëgojnë pronë nga familja e tyre e lindjes, krahasuar me 35% të atyre që deklaruan të kundërtën. Kjo nënkupton një ndryshim sesi janë të perceptuara femrat e rritura, si anëtare të familjes së burrit, përballë vajzave anëtare të familjes së lindjes.

**Figura 31. Sipas mendimit tuaj, a duhet gratë të trashëgojnë pronë nga familjet e tyre të lindjes/gjinisë?**



Numri i të anketuarve meshkuj (56%) të cilët besonin se femrat duhet të trashëgojnë pronë prej familjes së tyre të lindjes ishte shumë më i vogël krahasuar me numrin e femrave që kanë deklaruar të njëjtën gjë (63%). Sa i përket etnicitetit, të anketuarit serbë (37%) kishin më pak tendencë të deklarorin që femrat duhet të trashëgojnë pronë nga familja e tyre e lindjes, krahasuar me të anketuarit shqiptarë (60%) dhe të minoriteteve tjera jo-serbe (68%).


## FOKUS GRUPI ME QYTETARË SERBË

*“Unë e di një rast ku vëllai e ka shitur të gjithë pasurinë e trashëguar të familjes dhe nuk u ka dhënë asnjë para motrave të martuara. Ai këtë pasuri ua la fëmijëve të tij.”*

### PJESËMARRËS MASHKULL

Përsëri, rezultatet ishin më pozitive në regjionin e Ferizajit, dhe më negative në regjionin e Pejës (29.2%).

**Figure 32. Sipas mendimit tuaj, a duhet gratë të trashëgojnë pronë nga familjet e tyre të lindjes/gjinisë? – Ndarja sipas gjinisë**




Të gjeturat nga fokus grupet tregojnë se edhe pse shumica e pjesëmarrësve pajtohen se femrat kanë të drejta në trashëgimi, ata mendojnë se kjo nuk po ndodh aktualisht në Kosovë. Ka pasur gjithashtu pjesëmarrës të cilët kanë deklaruar se femrat nuk kanë të drejtë të trashëgojnë të njëjtën shumë të pasurisë sikurse meshkujt, pasi që ato jetojnë në shtëpinë e burrit pasi të martohen.

Në pyetjen nëse ata mbajnë mend ndonjë rast kur vajza ka trashëguar pronë nga të njohurit e tyre, shumica e të anketuarve deklaruan se ata nuk mbajnë mend të ketë ndodhur një gjë e tillë. Përderisa, rreth

62% e të anketuarve nuk mbanin mend ndonjë rast kur vajza ka trashëguar pronë, rreth 33% e tyre mbanin mend për një ose më shumë raste të tillë.


**Figura 33. Në rrethin tuaj të të njohurve, sa raste mund të ju kujtohen ku një vajzë ka trashëguar pronë?**



Të anketuarit shqiptarë kishin më pak tendencë të kujtonin ndonjë rast kur femra në rrethin e tyre kishte trashëguar ndonjë pronë (65%) sesa serbët (17%) dhe minoritetet e tjera jo-serbe (39%).

Në pyetjen rreth perceptimeve të njerëzve në komunitetin e tyre rreth trashëgimisë, 29% e të anketuarve deklaruan se baballarët janë “shumë mbështetës” ndaj të drejtave të vajzave për të trashëguar, 34% deklaruan se ata janë “deri diku mbështetës”, 18% deklaruan se ata janë “as mbështetës as jo mbështetës”, 9% se ishin “deri diku jo mbështetës”, dhe vetëm 6% deklaruan se ata nuk ishin “fare mbështetës”.

**Figure 34. Sipas jush, sa mbështetës janë baballarët në rrethin tuaj në lidhje me të drejtën e vajzave për të trashëguar?**



Kjo dukuri ka ndryshime drastike mes regjioneve. Në Gjakovë, vetëm 3% thanë se baballarët janë shumë mbështetës, ndërsa në Ferizaj 72.4% thanë të njëjtën gjë. Në Mitrovicë, 40.2% thanë që baballarët janë shumë mbështetës, ndërsa në Prizren vetëm 11% thanë të njëjtën gjë.

Në regjionet e tjera të njëjtat përgjigje sillen nga 25% dhe 39%. Ndërsa ndryshimet sipas etnicitetit, moshës dhe gjinisë nuk ishin shumë drastike.

Gjatë diskutimeve në fokus grupe, pjesëmarrëseve femra i'u kërkua t'i ndanin përvojat e tyre sa i përket trashëgimisë. Shumica prej tyre deklaruan se nuk kanë trashëguar pronë të patundshme nga familjet e tyre të lindjes. Ato thanë se askush nuk i ka pyetur nëse duan të trashëgojnë pronë, por, as ato nuk kanë kërkuar të jenë pjesë e trashëgimisë.

Gjatë këtyre diskutimeve, u raportuan shumë raste kur femrat ishin përjashtuar nga trashëgimia. Një femër nga regjioni i Gjilanit deklaroi se vëllezërit e saj nuk e kishin pyetur fare nëse ajo donte të trashëgonte.

## FOKUS GRUPI NË FERIZAJ

*“As unë dhe as motrat e mia nuk kemi dashur të marrim hise në pasuri. E gjitha që duam ne është të shohim familjen e lumtur, dhe tani që jemi të martuara të kemi mundësi të shkojmë dhe vizitojmë familjen tonë të lindjes.”*


### PJESËMARRËSE FEMËR

Sipas këtyre pjesëmarrësve, arsyeja kryesore e kësaj dukurie është tradita, pasi që tradicionalisht, femrat janë mësuar nga familjet e tyre se ato nuk duhet të kërkojnë trashëgiminë. Kjo dukuri ishte më e dukshme në regjionin e Pejës, ku femrat fuqishëm kundërshtonin faktin se femrat duhet të trashëgojnë dhe e pranoin se ato kurrë nuk do të merrnin trashëgiminë nga vëllezërit e tyre edhe nëse do t'u ofrohej një gjë e tillë.

Sipas të anketuarve, nënat janë pak më shumë mbështetëse sesa baballarët për të drejtat e vajzave për të trashëguar. Rreth 40% e të anketuarve deklaruan se nënat janë “shumë mbështetëse” në këtë aspekt, 33% thanë që ato ishin “deri diku mbështetëse”, 15% thanë se ato ishin “as mbështetëse as jo mbështetëse”, 5% thanë që ato ishin “deri diku jo mbështetëse” dhe 3% se ato nuk ishin “fare mbështetëse”.


Në të njëjtën mënyrë, këtu ka pasur shumë pak dallime mes gjinive dhe grup moshave të ndryshme. Minoritetet e tjera deklaruan më shumë sesa shqiptarët dhe serbët se nënat ishin shumë mbështetëse dhe deri diku mbështetëse në këtë aspekt (80%, 73%, 56%). Veç kësaj, në Ferizaj njerëzit (87.4%) deklaruan më shumë se në Gjakovë (6.6%) se nënat janë shumë mbështetëse për të drejtat e vajzave për të trashëguar. Regjionet e tjera sillen mes 26% dhe 64.7%.

**Figura 35. Sipas jush, sa mbështetës janë nënat në rrethin tuaj në lidhje me të drejtën e vajzave të tyre për të trashëguar?**



Mbështetja e vëllezërve për të drejtat e motrave për të trashëguar ishte shumë e ulët sipas të anketuarve. Vetëm 16% e tyre deklaruan se vëllezërit janë “shumë mbështetës në këtë aspekt” dhe 31% thanë se ata janë “deri diku mbështetës”.

**Figure 36. Sipas mendimit tuaj, sa përkrahës janë vëllezërit në komunitetin tuaj për të drejtat e motrave të tyre për të trashëguar?**



Gjakovë dhe Gjiilan, pothuajse askush nuk deklaroi se vëllezërit ishin “shumë mbështetës” (0% dhe 2.2%), ndërsa edhe në regjionin më të fuqishëm, Ferizaj, vetëm 32 % deklaruan një gjë të tillë. Vetëm 2.5% e serbëve përballë 16.5% të shqiptarëve deklaruan se vëllezërit janë shumë mbështetës.



Kjo nënkupton se kampanjat më të fuqishme vetëdijësuese duhet t'u drejtohen vëllezërve, të cilët mund të jenë më rezistentët në të gjitha regjionet dhe etnicitetet në lidhje me të drejtat e motrave të tyre për të trashëguar.

Organet shtetërore<sup>6</sup> vlerësohen si mbështetëse në përgjithësi ndaj të drejtave të grave për të trashëguar.

## FOKUS GRUPI ME MINORITETE JO-SERBE


*“Unë kam dy motra dhe një vëlla. Babai jonë e ka ndarë pasurinë vetëm në mes meje dhe vëllait. Nuk e di nëse janë pyetur motrat a dëshirojnë të përfshihen në trashëgimi. Ky proces nuk është rregulluar me procedura të rregullta gjyqësore.”*

### PJESËMARRËS MASHKULL

Rreth 28% e të anketuarve besonin se institucionet shtetërore janë “shumë mbështetëse” në këtë aspekt, 34% besonin se ato janë “deri diku mbështetëse”, 11% se ato janë “as mbështetëse as jo mbështetëse”, dhe 8% besonin se këto institucione janë “deri diku jo mbështetëse” dhe “fare mbështetëse”.

Mbi 50% e minoriteteve të tjera besojnë se organet shtetërore janë shumë mbështetëse, krahasuar me 26.5% të shqiptarëve dhe 32.3% të serbëve. Meshkujt gjithashtu besonin një gjë të tillë më shumë sesa femrat (32.7% përballë 22.6%). Në Pejë dhe Prishtinë, vetëm 4.2% dhe 7.5% deklaruan se organet shtetërore janë shumë mbështetëse, krahasuar me 47.2% në Prizren dhe 44.1% në Gjiilan.

**Figura 37. Sipas jush, sa përkrahës janë organet shtetërore/institucionet në qoftë se një grua kërkon të drejtën e saj për të trashëguar?**



Në përgjithësi, pjesëmarrësit e fokus grupeve e pranojnë faktin se organet shtetërore luajnë një rol të madh në të drejtat e femrave për të trashëguar pronë. Sipas tyre, ka shumë raste kur organet shtetërore i mbështesin femrat për të marrë trashëgiminë, por femrat janë ato të cilat heqin dorë nga të drejtat e tyre për të trashëguar pronë.

<sup>6</sup> Organet shtetërore përfshijnë: Gjyqësorin, Agjencinë Kosovare të Pronës, qeverisjen lokale dhe qeverisjen qendrore


Kur të anketuarve iu kërkua që të identifikonin pengesat më të mëdha për të drejta të barabarta në trashëgimi, përgjigjet më të shpeshta ishin: "Trashëgimia kulturore e shoqërisë patriarkale (tradita) - nënshtrimi / diskriminimi i femrave" (64%) dhe "paragjykimi negativ shoqëror për të ndërmarrë veprime ligjore kundër anëtarëve të familjes së ngushtë" (39%). Vetëm 9% e të anketuarve besonin se "nuk ka pengesa në të tilla raste".

**Figura 38. Sipas mendimit tuaj, cilat janë pengesat për të drejta të barabarta për gratë mbi pronën?**



Të dyja palët meshkujt dhe femrat ndanin mendimet e njëjta sa i përket pengesave për të drejta të barabarta të femrave për të trashëguar. Në nën tjetër, në ndarjen sipas etniciteteve, rezultatet tregojnë ndryshime të vogla siç janë të ilustruara në tabelën e mëposhtme.

**Figura 39. Sipas mendimit tuaj, cilat janë pengesat për të drejta të barabarta për gratë mbi pronën? – Ndarja sipas etniciteve**



Rezultatet gjithashtu ndryshonin mes regjioneve siç shihet në tablën e mëposhtme.


**Figura 40. Sipas mendimit tuaj, cilat janë pengesat për të drejta të barabarta për gratë mbi pronën? – Ndarja sipas regjioneve**

	D12. REGJIONI						
	Prishtinë	Mitrovicë	Prizren	Pejë	Ferizaj	Gjakovë	Gjilan
Trashëgimia kulturore e shoqërisë patriarkale (tradita) - nënshtrimi / diskriminimi i femrave	81.8%	34.2%	66.9%	87.7%	88.1%	30.3%	49.6%
Paragjykimi negativ shoqëror për të ndërmarrë veprime ligjore kundër anëtarëve të familjes së ngushtë	53.1%	24.9%	42.3%	31.6%	4.2%	54.0%	47.5%
Tregjet jolikuide/ jo stabile të pronës/kërkesa të ulta për shitblerje të pronës	4.1%	18.3%	.6%	0.0%	1.1%	6.0%	7.0%
Procedura ligjore krijon armiqësi ndërmjet anëtarëve të familjes	8.5%	24.9%	18.4%	27.3%	12.4%	46.8%	55.2%
Shpërndarja/tjetërsimi i pronës e kërcënon mbijetesën/qëndrueshmërinë ekonomike të anëtarëve të tjerë të familjes	34.8%	19.5%	5.4%	.2%	17.6%	57.8%	32.9%
Shpenzimet e larta të procedurave ligjore për të siguruar të drejtat pronësore	4.3%	4.7%	1.4%	0.0%	5.9%	42.8%	13.7%
Mungesa e informacionit / edukimit për të drejtat e tyre mbi trashëgiminë e pronës	43.5%	11.3%	27.1%	5.6%	41.7%	6.0%	40.8%
Nuk ka pengesa	2.4%	26.2%	17.0%	7.2%	2.1%	4.0%	4.4%
Pa përgjigje/Ref	1.0%	6.9%	2.0%	4.5%	.2%	1.0%	3.0%
Nuk e di	0.0%	.1%	1.1%	.4%	.2%	0.0%	1.5%
Tjetër	13.7%	.8%	0.0%	0.0%	0.0%	1.0%	0.0%

Të anketuarit janë pyetur gjatë studimit se në çfarë mase pajtohen me deklaratën "gratë në Kosovë nuk i kërkojnë të drejtat e tyre për të trashëguar". Shumica e të anketuarve besonin se gratë nuk i kërkojnë të drejtat e tyre për të trashëguar. Më shumë se gjysma e tyre (52%) "pajtohen plotësisht" me këtë deklaratë, 32% e tyre "deri diku pajtohen", dhe vetëm 8% "deri diku nuk pajtohen" dhe "nuk pajtohen fare" me këtë deklaratë.

Përqindjet kanë qenë më të larta në regjionin e Pejës, ku 84.9% e tyre pajtoheshin plotësisht, ndërsa përqindjet më të vogla kanë qenë në Mitrovicë (36%) dhe Gjakovë (39.7%). Nuk ka pasur ndonjë ndryshim të madh mes të anketuarve femra dhe meshkuj dhe mes grup moshave të ndryshme. Serbët kanë pasur më shumë tendencë të pajtohen plotësisht me këtë deklaratë (63.7%) sesa shqiptarët (52%) dhe minoritetet e tjera (36.5%).

**Figura 41. Deri në çfarë mase pajtoheni me deklaratën e mëposhtme: "Gratë në Kosovë nuk kërkojnë të drejtat e tyre për të trashëguar"?**



Sipas të anketuarve, arsyet kryesore që gratë nuk i kërkojnë të drejtat e tyre për trashëgimi janë: "Frika nga bartja e pronës tek familja e burrit" (49%), "Pengesat kulturore të cilat mohojnë të drejtat e grave për të trashëguar" (44%) dhe "pritshmëria nga familja që ato mos të trashëgojnë" (38%). Mes arsyeve tjera gjithashtu janë "Mungesa e arsimimit/vetëdijesimit" (31%), "Frika e izolimit nga rrethi dhe fqinjët" (25%) dhe "Mungesa e njohurive për të drejtat e tyre trashëgimore" (20%). Është interesante të ceket se arsyeja kryesore e këtij fakti është "Frika nga bartja e pronës tek familja e burrit"; kjo tregon edhe një herë se prona që trashëgohet perceptohet ndryshe nga llojet tjera të pronës.

Prona e trashëguar konsiderohet më shumë t'i përket familjes sesa një individi, dhe prandaj bartja e saj tek ndonjë familje tjetër është frikë. Në regjionin e Pejës dhe Prizrenit, "pengesat kulturore" identifikoheshin më shpesh (71.7% dhe 61.9%) sesa në regjionet tjera. Në Gjakovë dhe Pejë "Mungesa e njohurive për të drejtat e tyre në trashëgimi" u identifikua më shpesh sesa në regjionet tjera (6.2% dhe 3.4%).


Këto rezultate mund të kërkojnë hulumtime më të thella për të përcaktuar pse disa regjione tregojnë më shumë njohuri për këto çështje, dhe se ndoshta faktorët kulturor janë më të fuqishme në disa zona e më pak në disa zona tjera.

**Figura 42 Sipas jush, cilat janë tri arsyt kryesore pse femrat nuk kërkojnë të drejtën e tyre për të trashëguar?**



Shumica e të anketuarve besonin se femrat heqin dorë apo i refuzojnë të drejtat e tyre për trashëgiminë e pronës (87%). Vetëm 10% deklaruan se femrat nuk heqin dorë/refuzojnë të drejtat e tyre për të trashëguar pronë. Kjo ka qenë pothuajse e njëjtë si për meshkuj ashtu edhe për femra. Sa i përket kësaj çështje, shumica e regjioneve silleshin prej 86.7 deri në 93.8%. Vetëm Mitrovica dallohej këtu: vetëm 59.4% e banorëve të këtij regjioni u pajtuan me këtë fakt. Kjo do të mund të kërkonte hulumtim të mëtejshëm për të përcaktuar nëse ky perceptim është i saktë dhe pajtueshmëria në Mitrovicë është shumë më e ulët.

**Figura 43. A jeni të mendimit se femrat shpesh heqin dorë apo tërhiqen nga të drejtat e tyre pronësore/trashëgimore?**



Të anketuarit e etnicitetit serbë besonin më shumë se femrat shpesh heqin dorë apo tërhiqen nga të drejtat e tyre pronësore/trashëgimore. Nga këta të anketuar, 22% e tyre deklaruan se femrat nuk heqin dorë nga të drejtat e tyre pronësore/trashëgimore, krahasuar me vetëm 10% të anketuarve shqiptarë dhe 6% minoriteteve tjera.


## DISKUTIM FOKUS GRUPI ME QYTETARË SHQIPTARË

*“Kur unë jam martuar, ngritja e çështjes për të trashëguar nga familja e lindjes ka qenë e pamundur.”*

### PJESËMARRËSE FEMËR

Vetëm 36% e të anketuarve deklaruan se familja e tyre ka kaluar nëpër procedurat e ndarjes së trashëgimisë. Kjo ka qenë e krahasueshme mes femrave dhe meshkujve. Ashtu siç edhe pritej, personat më të vjetër kishin kaluar nëpër procedurat e trashëgimisë (60% e atyre mbi 65 vjeç krahasuar me 30% të atyre mes 25-34 vjeç).


**Figura 44. A ka kaluar familja juaj e lindjes/gjinisë përmes procedurave trashëgimore? - Përqindja “Po” ndarja sipas gjinisë**



Krahasuar sipas etniciteteve, serbët kishin kaluar nëpër procedura trashëgimore më pak (11%), sesa minoritetet tjera (22%), dhe shqiptarët (37%).

Në këtë pyetje, banorët e Ferizajt u përgjigjën më së paku me “po” (9.4%) ndërsa banorët e Prishtinës dhe Gjakovës më së shumti (53.4% dhe 54.8%).

**Figura 45. A ka kaluar familja juaj e lindjes/gjinisë përmes procedurave trashëgimore? – Ndarja sipas gjinisë**



Neni 130 i Ligjit për Trashëgimi në Kosovë garanton të drejtën për të hequr dorë nga trashëgimia përmes një deklaratë të bërë në gjykatë.<sup>7</sup> Shumica e të anketuarve, familjet e të cilëve kanë kaluar në procedura trashëgimore, deklaruan se ata nuk kanë hequr dorë nga të drejtat e tyre trashëgimore, ndërsa vetëm 19% e tyre thanë se kishin hequr dorë nga kjo e drejtë.

Përqindja e të anketuarve femra (34%) të cilat deklaruan se kanë hequr dorë nga të drejtat e tyre trashëgimore ishte shumë më e lartë sesa e meshkujve të cilët deklaruan të njëjtën gjë (6%).

Gjithashtu pati ndryshime të mëdha sipas regjioneve. Vetëm 3.8% e të anketuarve në Mitrovicë, 12.5% në Gjilan, 13.6% në Pejë, 14.3% në Prizren, dhe 16% në Prishtinë kishin hequr dorë nga kjo e drejtë, krahasuar me 45.5% në Ferizaj dhe 40% në Gjakovë.


Këtu mund të vërehen ndryshime edhe sipas etniciteteve. Vetëm 8.7% e serbëve kishin hequr dorë krahasuar me 19.2% shqiptarë dhe 31.8% minoritete tjera.

Përfundimisht, 31.6% e të anketuarve mbi 65 vjeç kishin hequr dorë krahasuar me rreth 20% të grup moshave tjera.

<sup>7</sup> Ligji për Trashëgimi në Kosovë (Ligji No. 2004/26)



**Figura 46. Personalisht, a keni hequr dorë nga e drejta e juaj mbi pronën / trashëgiminë? – Ndarja sipas gjinisë**




Kur të anketuarit u pyetën për arsyet që ata kanë hequr dorë nga të drejta e tyre mbi pronën/trashëgiminë, përgjigjet më të zakonshme ishin: “pengesat kulturore të cilat mohojnë të drejtat e grave për të trashëguar” (19%) dhe “Frika nga bartja e pronës tek familja e burrit” (12%). Duhet cekur se 18% e të anketuarve deklaruan se kishin arsye “tjera” se përse ata kishin hequr dorë nga këto të drejta. Mes përgjigjeve të dhëna si “tjetër” ishin:

- Unë nuk dua pronë nga prindërit e mi;
- Unë dua të krijoj pasuri me familjen time/me familjen e burrit;
- Dëshirë personale;
- Mundësia e krijimit të armiqësisë në familje.

Nga arsyet e dhëna se pse të anketuarit kanë hequr dorë nga të drejtat e tyre në trashëgimi 24.7% e tyre deklaruan se “familja e tyre pret që ato mos trashëgojnë” dhe 14.3% deklaruan se është “Frika për të transferuar pronën tek familja e burrit”

“Frika nga bartja e pronës tek familja e burrit” ishte një brengë më e madhe në Mitrovicë (50%) sesa në Prizren (37.5%) ose Prishtinë (20.8%). Duhet përmendur se numrat absolut për këtë pyetje ishin shumë të vegjël mes regjioneve të ndryshme.


**Figura 47. Pse keni hequr dorë nga drejta e juaj mbi pronën / trashëgiminë?**



### 3.3 KËNAQSHMËRIA ME SHËRBIMET GJYQËSORE NË ZGJIDHJEN E KONTESTEVE PRONËSORE


Vetëm 5% e të anketuarve kanë thënë se kanë pasur një rast lidhur me pronën të paraqitur në gjykatë.

**Figura 48. A keni pasur ndonjëherë një rast lidhur me pronën të paraqitur në gjykatë?**



Nga një total prej 57 të anketuarve të cilët kishin një kontest pronësor, 43 prej tyre ishin meshkuj (6.9% e të gjithë të anketuarve meshkuj) dhe vetëm 14 ishin femra (2.2% e të gjithë të anketuarve femra). Në rajonin e Prishtinës, 9.1% e të anketuarve kishin një rast të lidhur me pronë, dhe në rajonin e Gjilanit 8.1% kishin një rast të tillë, që i bie vlera më të larta se mesatarja prej 4.6%. Për shkak të këtyre vlerave të vogla numerike, përqindjet bëhen më pak të rëndësishme kur ato shpërndahen sipas moshës, përkatësisë etnike, gjinisë, apo rajonit.


**Figura 49. A keni pasur ndonjëherë një rast lidhur me pronën të paraqitur në gjykatë? – Të shpërndarë sipas gjinisë**



Nga ata që kishin një kontest pronësor, 26% kishin paraqitur rastin në gjykatë para vitit 1999. Rastet para vitit 1999 kishin të bënin me "procedurë kontestimore mbi bazën e kontratës së shit-blerjes për vërtetimin e të drejtës pronësore (paditësi-ja /i/e padituri)" (32%), "trashëgimia familjare, procedura e rregullt gjyqësore" (26%), "kthimi i të drejtës së pronës, veprim ligjor përtej familjes së ngushtë" (14%), "procedurë kontestimore mbi bazën e trashëgimisë me anë të marrëveshjes/ujdi gjyqësore" (13%) ose "trashëgimi familjare, mosmarrëveshje rreth veprimeve ligjore (paditësi / padituri)" (8%).


Shumica nuk ishin të kënaqur me kohën që gjykata mori të procedojë rastin. Pakënaqësia është e dukshme, pasi vetëm 13% e të anketuarve pohuan se ishin të kënaqur me kohën e procedimit, ndërsa 81% e të anketuarve ishin të pakënaqur.

**Figura 50. A jeni të kënaqur me kohën e procedimit të rastit nga gjykata? (n = 21)**




Nga një total prej 57 të anketuarve të cilët kishin një kontest pronësor, 61% e të anketuarve kanë paraqitur rastin në gjykatë pas vitit 1999. Nga këto, llojet më të zakonshme të rasteve gjyqësore që të anketuarit kanë paraqitur ishin "proceset gjyqësore për ndarje fizike të pronës "(29%) dhe "procedurë kontestimore mbi bazën e kontratës se shit-blerjes për vërtetimin e të drejtës pronësore (paditësi-ja /i/e padituri)"(23%). Më pak të shpeshta ishin rastet si "trashëgimi familjare, mosmarrëveshje rreth veprimeve ligjore (paditësi / i padituri) " (13%), "procedurë kontestimore mbi bazën e trashigëmisë me anë të marrëveshjes/ujdi gjyqësore " (10%), dhe "trashëgimi familjare, procedurë të rregullt gjyqësore" (10% ). Kurse vetëm një i anketuar tha se kishte paraqitur rastin pas vitit 1999 për "kthimin e të drejtës së pronës, veprim ligjor përtej familjes së ngushtë".

**Figura 51. Cili ka qenë lloji i rastit gjyqësor në të cilin ju keni qenë i përfshirë? (n = 57)**




Në anën tjetër, femrat kanë shumë gjasa të përfshihen në trashëgimi. Marrë parasysh që kemi të bëjmë me një mostër të vogël të femrave, megjithatë, 67% e tyre janë përfshirë në procese trashëgimore jo-kontestimore.

**Figura 52. Llojet e rasteve të trashëgimisë**




Kur u pyetën në lidhje me iniciatorin e veprimit ligjor në gjykatë, 48% e të anketuarve meshkuj thanë se ata personalisht kanë iniciuar veprimin ligjor, në krahasim me 25% të femrave që e deklaruar të njëjtën gjë. Shumica e të intervistuarve femra (67%) thanë se një anëtar mashkull i familjes së tyre ishte ai që inicioi rastin në gjykatë.

**Figura 53. Kush e inicioi veprimin ligjor në gjykatë? – E shpërndarë në gjini (n = 57)**




Nga të gjithë të anketuarit, 41% të rasteve janë zgjidhur në favor të të anketuarve, dhe pjesa tjetër prej 43% janë ende në proces. Vetëm 10% e rasteve janë zgjidhur jo në favor të të anketuarve.

**Figura 54. A është zgjidhur rasti në favor tëndin? (n = 43)**




Ndërsa 73% e të anketuarve femra kanë deklaruar se rasti që ato ishin të përfshira u zgjidh në favor të tyre, vetëm 30% e të anketuarve meshkuj pohuan të njëjtën gjë. Përsëri, vini re se numri i të anketuarve këtu është shumë i vogël. Përveç kësaj, 57% e rasteve të të intervistuarve meshkuj janë ende në proces.

**Figura 55. A është zgjidhur rasti në favor tëndin? – E shpërndarë në gjinisë (n = 43)**



Nga të gjithë të anketuarit, 61% deklaruan se ishin të kënaqur me vendimin e gjykatës, ndërsa 18% thanë se nuk ishin.

**Figura 56. A jeni të kënaqur me vendimin e gjykatës? (n = 25)**



Kur u pyetën të anketuarit se çfarë nuk e pëlqen në lidhje me procesin gjyqësor, shumica e të anketuarve thanë se nuk iu pëlqejnë "vonesat e gjata në proceset gjyqësore" (69%). 37% deklaruan se "nuk mund të përballojnë të gjitha shpenzimet për të kompletuar rastin", dhe e njëjta përqindje ka thënë se "vendimi i gjykatës ishte i papërshtatshëm dhe i pakuptimtë".

**Figura 57. Çfarë nuk e pëlqen në lidhje me procesin gjyqësor? (n = 10)**




Për 36% e të anketuarve, rasti në të cilin ishin të përfshirë zgjati për rreth një vit, ndërsa koha me e gjatë që ka marrë që një rast të zgjidhet ishte tetë vjet (7%).

## FOKUS GRUP ME PËRDORUES GJYKATASH

*“Procedurat gjyqësore marrin shumë kohë dhe stafi që punon në këto gjykata në të shumtën e rasteve është joprofesional. Mendoj se gjykatat nuk funksionojnë si duhet sepse marrin shumë kohë që një rast të zgjidhet.”*

## PJESËMARRËS MASHKULL

**Figura 58. A mund të na tregoni sa gjatë ka zgjatur procesi i zgjidhjes së rastit?**



Kur iu është kërkuar që të vlerësojnë kënaqshmërinë e tyre me disa shërbime gjyqësore në një shkallë nga 1 (shumë i pakënaqur) deri në 5 (shumë i kënaqur), të anketuarit kanë treguar nivelin më të madh të kënaqshmërisë me "udhëzim të dhënë nga stafi i gjykatës" (3.78/5) dhe "trajtimi nga gjyqtari" (3.75/5). Ndërkohë, ata treguan nivel më të ulët të kënaqshmërisë me "kohën" (2.92/5) dhe "koston e procedurave gjyqësore" (3.04/5).

**Figura 59. A mund të na tregoni nivelin e kënaqshmërisë me shërbimet e mëposhtme gjyqësore? (1 = shumë i pakënaqur, 5 = shumë i kënaqur)**






Në përgjithësi, pjesëmarrësit e fokus grupeve treguan nivele mesatare të kënaqësisë me shërbimet e pranuar nga gjykata gjatë rasteve që ata ishin të përfshirë. Megjithatë, përdoruesit e gjykatës që kanë marrë pjesë në seancat e fokus grupeve kishin prirje për të menduar se rastet e trashëgimisë marrin shumë kohë për t'u zgjidhur.


Sipas shumicës së të anketuarve, rastet që lidhen me të drejtat e pronësisë duhet dhënë "prioritet shumë të lartë" (71%) në sistemin e drejtësisë. Për më shumë, 23% pohuan se i duhet dhënë "prioritet të lartë", ndërsa vetëm 6% ishin të mendimit se rasteve pronësore duhet t'u jepet "prioritet i ulët".

**Figure 60. Sipas mendimit tuaj, a duhet që rasteve pronësore t'u jepet prioritet i lartë nga sistemi gjyqësor? (n = 57)**



Kur u pyetën se cilat raste merituan prioritet, dy përgjigjet më të përzgjedhura të të anketuarve ishin "mosmarrëveshjet familjare lidhur me trashëgiminë e pronës" (79%) dhe "përdorimi i paligjshëm i rasteve pronësore" (62%). Rastet e ndërlidhura me "mosmarrëveshjet lidhur me shpërndarjen e trashëgimisë familjare - femrës" (45%) dhe "pretendimet për vlerë të lartë" (42%) janë gjithashtu ndër prioritetet kryesore, "Rastet kur palët i përkasin grupeve të ndryshme etnike (veçanërisht personat e zhvendosur)" janë të identifikuar si rastet që meritojnë trajtim me prioritet më të vogël.

**Figura 61. Cilat raste specifike të pronësisë meritojnë trajtim me prioritet? (n =57)**




Të anketuarit të cilët kishin pasur raste të trashëgimisë në gjykatë, janë pyetur për vështirësitë kryesore gjatë procedimit të rastit. Tre vështirësitë më të shpeshta ishin "shërbime të shtrenjta ligjore" (70%), "dëshmi të humbura/ jo të dokumentuara plotësisht" (70%), dhe "identifikimi i pavend i pronës / ndërtimeve të paligjshme (jo të regjistruar)" (56%).

**Figura 62. Cilat janë tri vështirësitë kryesore që keni përjetuar gjatë procedimit të rastit të trashëgimisë? (n = 10)**



Nga të gjithë të anketuarit, 44% thanë se gjykata ka marrë hapa për të verifikuar se të gjithë anëtarët e familjes dhe trashëgimtarë të mundshëm janë identifikuar, ndërsa 28% e të anketuarve deklaruan se gjykata nuk e ka bërë verifikimin. Sa i përket veprimeve të ndërmarra për verifikim, shumica e të intervistuarve deklaruan se gjykata "ka kërkuar dëshmi të zyrës civile të regjistrimit" (94.2%).

**Figura 63. Çfarë hapa ka ndërmarrë gjykata? (n = 10)**




Pjesëmarrësve të fokus grupeve të cilët kanë pasur përvojë të mëparshme me raste pronësore u është kërkuar të japin rekomandimet e tyre se si shërbimet gjyqësore mund të përmirësohen. Nga përgjigjet e tyre është sugjeruar rritja e numrit të gjyqtarëve që merren me raste pronësore, duke eliminuar procedurat burokratike, dhe duke i dhënë asistencë grave për procedurat gjyqësore dhe përjashtimin nga taksat administrative.

Për sa i përket grupeve të pakicave etnike që kanë vështirësi të veçanta në qasje në gjykata, të anketuarit shprehën shqetësim. 41% e të intervistuarve deklaruan se "nuk ka" vështirësi të pranishme në të tilla raste, ndërsa 29% besonin se pakicat kanë vështirësi në qasje në gjykata. Ndërkohë, 27% e të intervistuarve thanë se ata nuk kanë informacion lidhur me këtë temë.

Kur janë shpërndarë sipas përkatësisë etnike, 29.4% e shqiptarëve besojnë se pakicat kanë vështirësi, ndërsa 20% e serbëve dhe 0% e pakicave të tjera besojnë se grupet etnike minoritare kanë vështirësi në qasje në gjykata. Përsëri, vetëm 59 të anketuarit u përgjigjën në këtë pyetje, nga të cilat 51 ishin shqiptarë, 5 ishin serbë, dhe 3 ishin nga pakicat tjera.


**Figura 64. Prej këndvështrimit tënd, a kanë grupet etnike minoritare vështirësi në qasje në gjykata? (n = 57)**



Ata që deklaruan se grupet e pakicave etnike kanë vështirësi në qasje në gjykata janë pyetur më tej në lidhje me hapat që gjykatat mund të ndërmarrin për të zbutur këto vështirësi. Sipas shumicës së të anketuarve, gjykatat duhet të "sigurojnë asistencë gjuhësore" (72%), "të sigurojnë shërbim edukues bazik ligjor/materiale informative në gjuhën e tyre" (59%), ose "të angazhojnë zyrtarë të pakicave/punonjës prej minoriteteve" (47%). Më pak të anketuar ishin të mendimit se gjykatat duhet vendosur degët e gjykatave

në vende të pakicave dhe të ofrojnë ndihmë juridike në gjuhën e tyre. Shpërndarja në mes të shqiptarëve dhe pakicave nuk tregon dallime të rëndësishme.


**Figura 65. Çfarë mund të bëjnë gjykatat për të zbutur këto vështirësi (n = 21)**



Ekziston një konsensus i përgjithshëm se gjykatat në Kosovë i trajtojnë pakicat në mënyrë të drejtë dhe në mënyrë të barabartë, dhe japin vendime të paanshme, të drejta dhe të ndershme. Një total prej 36% e të anketuarve "plotësisht u pajtuan" me këtë deklaratë, 29% "u pajtuan disi", "krahasuar me vetëm 1% e të anketuarve që "nuk u pajtua plotësisht."

Megjithatë, kur ndahen sipas përkatësisë etnike është pak më ndryshe. Ndërsa 37.3% e shqiptarëve "plotësisht u pajtuan" dhe 29.4% e shqiptarëve "u pajtuan disi", asnjë serb apo pakicë tjetër nuk ka hy në këto kategori. Nga të gjithë të anketuarit serbë 81% "tërësisht ose disi nuk u pajtuan", ndërsa 33% e pakicave të tjera nuk u pajtua plotësisht. 66% e pakicave të tjera nuk iu përgjigjën pyetjes, kështu që duhet të theksohet se këto shifra kanë një marzhë të lartë të gabimit.

**Figura 66. A pajtoheni se gjykatat në Kosovë i trajtojnë minoritetet paanshëm dhe barabartë, si dhe u shqiptojnë vendimet gjyqësore të drejta dhe të paanshme? (n = 57)**




Me qëllim të rritjes së besimit të komuniteteve pakicë në sistemin gjyqësor, të anketuarit besojnë se gjykatat duhet kryesisht "të rrisin transparencën" (55%), "të përmirësojnë qasjen" (45%), dhe të "thjeshtojnë procedurat" (35%). Nga ana tjetër, "hartimi i dispozitave të veçanta për pakica në procedurat gjyqësore (akte afirmative)" (23%) dhe "ulja shpenzimeve" (17%) janë identifikuar si më pak të zgjedhura nga të anketuarit. Nuk kishte dallime të mëdha këtu në mes etnive.

**Figura 67. Çfarë duhet të bëjnë gjykatat që të rritet besueshmëria e pakicave në sistemin gjyqësor? (n = 57)**




Të anketuarve gjithashtu iu adresuan edhe pyetje në lidhje me sfidat e grave në qasje në gjykata. Sipas shumicës së të anketuarve, gratë nuk kanë vështirësi të veçanta në qasje në gjykata. Gjysma e të anketuarve deklaroi se nuk ka vështirësi për gratë në këtë drejtim (50%), 24% prej tyre pretendonte se ka pasur vështirësi, ndërsa 21% e të anketuarve nuk e dinë apo refuzuan të përgjigjen pyetjes.

**Figura 68. Prej këndvështrimit tuaj, a kanë femrat vështirësi sa i përket qasjes në gjykata? (n = 57)**



Nuk ka dallime të mëdha kur përgjigjet janë të shpërndara sipas gjinisë.

**Figura 69. Prej këndvështrimit tuaj, a kanë femrat vështirësi sa i përket qasjes në gjykata? – Të shpërndara sipas gjinisë (n = 57)**




Tre përgjigjet më të zgjedhura kur u pyetën se si gjykatat mund të zbutin vështirësitë me të cilat ballafaqohen gratë në qasjen në gjykata, ishin “rritja e transparencës (76%), “duke punësuar më shumë gra në administratën gjyqësore” (68%), dhe “rritja e efikasitetit” (58%). Përsëri, nuk ka pasur dallime të mëdha kur janë shpërndarë përgjigjet sipas gjinisë. Vini re se vetëm të anketuarit që janë përgjigjur se gratë që janë përballur me vështirësi u është bërë kjo pyetje, kështu që numri i të anketuarve është shumë i ulët.

**Figura 70. Çka duhet të bëjnë gjykatat që të zbuten këto vështirësi? (n = 17)**




Ka një pajtim të përgjithshëm në lidhje me atë se gjykatat në Kosovë i trajtojnë gratë në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe të paanshme, duke siguruar gjykime të drejta dhe të ndershme. Nga të gjithë të anketuarit, 41% janë "plotësisht të pajtimit" me deklaratën, 39% "u pajtuan disi", ndërsa vetëm 2% e tyre "nuk u pajtua plotësisht."

**Figura 71. A pajtoheni se gjykatat në Kosovë trajtojnë femrat drejtë, barabartë, dhe u sigurojnë gjykime të paanshme, të drejta dhe të ndershme? (n = 57)**



Megjithatë, ndërsa shumica e të anketuarve meshkuj janë "pajtuar plotësisht" me deklaratën se "gjykatat në Kosovë trajtojnë gratë në mënyrë të drejtë dhe në mënyrë të barabartë dhe sigurojnë gjykime të paanshme, dhe të drejta" (52%), shumica e të anketuarve femra vetëm "u pajtuan disi" me të njëjtën deklaratë (50%). Vetëm 20% e grave "u pajtuan plotësisht".

**Figura 72. A pajtoheni që gjykatat në Kosovë trajtojnë femrat në mënyrë të drejtë dhe në mënyrë të barabartë dhe sigurojnë gjykime të paanshme, dhe të drejta? – Të shpërndarë sipas gjinisë (n57)**



Përdorueset femra të shërbimeve të gjykatave që kanë marrë pjesë në diskutimet e fokus grupeve u ankuan për përvojat e tyre në gjykata. Disa prej tyre thanë se jo vetëm që rastet janë trajtuar shumë ngadalë, por edhe nuk kanë marrë ndihma dhe përkrahje adekuate nga gjykata.

Shumica e të anketuarve besonin se noterët në Kosovë trajtojnë gratë në mënyrë të drejtë dhe të barabartë, dhe ofrojnë shërbime të paanshme, të drejta dhe të ndershme. 46% e të anketuarve janë "plotësisht dakord" me deklaratën, dhe 32% janë "pajtuar disi." Përsëri, një numër i madh i grave janë "pajtuar disi" (40%) me deklaratën, në krahasim me të anketuarit meshkuj, ku pjesa më e madhe e tyre janë "plotësisht dakord" me të njëjtën deklaratë (54%).


## DISKUTIM NË FOKUS GRUP ME PËRDORUESIT E GJYKATAVE

*“Kam pasur shumë probleme gjatë rastit. Unë vetë kam iniciuar rastin në gjykatë, por gjykata nuk më ka trajtuar mirë dhe nuk më kanë ofruar ndihmën e nevojshme. Më është dashur t’i kuptoja dhe bëja të gjitha vetë.”*

### PJESËMARRËSE FEMËR



**Figura 73. A pajtoheni që noterët në Kosovë trajtojnë gratë në mënyrë të drejtë dhe të barabartë, dhe ofrojnë shërbime të paanshme, të drejta dhe të ndershme? (n = 57)**



Sipas të të anketuarve, gjykatat mund të bëjnë një sërë aktiviteteve me qëllim të rritjes së besimit të grave në sistemin gjyqësor. Përgjigjet më të shpeshta kanë qenë që gjykatat duhet "rritur transparencën" (49%), "të ndërmarrin fushata të informimit publik dhe të edukimit lidhur me sistemin gjyqësor dhe të drejtat e grave" (41%), dhe "të rrisin efikasitetin" (37%), në mënyrë që të rritet besimi i grave. Të ndara sipas gjinisë, rezultatet tregojnë se një numër i lartë i femrave besojnë se gjykatat duhet të zhvillojnë fushatat e informimit dhe edukimit të publikut, dhe duhet gjithashtu të sigurojnë trajnime mbi ndjeshmërinë gjinore në gjykatë (65% dhe 54% e femrave kundrejt 27% dhe 22% të burrat).

**Figura 74. Çfarë mund të bëjnë gjykatat që të rritet besueshmëria e grave në sistemin gjyqësor? (n = 57)**



Përdoruesit e gjykatës që kanë marrë pjesë në diskutimet e fokus grupeve besojnë se njerëzit në përgjithësi dhe gratë në veçanti, duhet të kenë më shumë qasje në informata në lidhje me të drejtat e tyre në trashëgimi. Ndër mënyrat e propozuara për të informuar njerëzit në lidhje me të drejtat e tyre mbi trashëgiminë janë:

- ⇒ Debatet televizive dhe reklamat informuese (Ferizaj: romë, ashkali dhe egjiptianë; Gjilan, Pejë, Prishtinë: shqiptarët; serbët nga Kosova jugore)
- ⇒ Fushatat e ndërgjegjësimit për të rriturit dhe fëmijët (Ferizaj, Gjilan, Prishtinë: shqiptarë & romë, ashkali dhe egjiptianë; serbë nga Kosova veriore)
- ⇒ Broshurat informuese (Ferizaj, Gjilan: shqiptarë & romë, ashkali dhe egjiptianë)
- ⇒ Kampanja në internet (Gjilan, Prishtinë: shqiptarë; serbë nga Kosova jugore)

## 4.0 PËRFUNDIME

Përderisa shumica e qytetarëve të Kosovës besojnë se ata posedojnë pasuri të patundshme, numri i pronarëve të regjistruar është shumë i vogël. Përveç kësaj, vetëm 19% e të gjitha të anketuarave femra kishin pronë të regjistruar në emrin e tyre, krahasuar me 79% të të anketuarave meshkuj. Në 74% të rasteve kur familja kishte vetëm një anëtar të familjes të regjistruar si pronar, 90% e tyre ishin meshkuj.

Në fakt, një numër i vogël i njerëzve kishin pronë të regjistruar, krahasuar me numrin e atyre që e konsideronin veten pronar. Kjo ndodh sidomos për pronën e trashëguar, dhe kjo nënkupton që duhet të punohet më shumë në edukimin e qytetarëve rreth asaj se pse është e rëndësishme të regjistrohet prona e trashëguar.

Më pak se gjysma e të anketuarave deklaruan se kanë njohuri për dokumentet e nevojshme për të iniciuar një rast trashëgimie. Dy në tri femra deklaruan se nuk kanë njohuri për këto dokumente, dhe një numër më i vogël i femrave krahasuar me meshkujt e dinin se procedura e trashëgimisë duhet të fillojë përmes noterit. Qytetarët serbë kishin më së paku njohuri rreth dokumenteve të nevojshme për një bartje të pasurisë të patundshme.

Shumica e të anketuarave besonin se femrat dhe meshkujt duhet të kenë të drejta të barabarta të pronësisë. Megjithatë, kur atyre iu kërkua të tregonin për raste specifike kur një vajzë në rrethinën e tyre kishte trashëguar pronë, më shumë se gjysma e të anketuarave nuk mbanin mend asnjë rast. Sipas gjysmës së të anketuarave, femrat në Kosovë nuk i kërkojnë të drejtat e tyre në trashëgimi, dhe shumica e të anketuarave besonin se femrat në fakt heqin dorë nga këto të drejta. Konkretisht, përqindja e femrave (34%) të cilat kanë kaluar nëpër procedura trashëgimore dhe kanë hequr dorë nga të drejtat e tyre për të trashëguar ishte shumë më e lartë sesa ajo e meshkujve të cilët kanë deklaruar të njëjtën gjë (6%). Pengesat kulturore të cilat mohojnë të drejtat e grave për të trashëguar dhe frika nga bartja e pronës tek familja e burrit ishin arsyet kryesore që femrat heqin dorë nga të drejtat e tyre pronësore/trashëgimore.

Shumica e femrave të cilat kanë qenë të përfshira në raste gjyqësore të lidhura me pronën deklaruan se një anëtar mashkull i familjes së tyre e kishte filluar procesin gjyqësor, krahasuar me shumicën e të anketuarave meshkuj të cilët deklaruan se ata personalisht e kanë filluar këtë proces. Përveç kënaqshmërisë së konsiderueshme me shërbimet gjyqësore, të anketuarit u ankuan për shërbime shumë të shtrenjta gjyqësore, mungesë/mos kompletim i provave, dhe identifikim jo adekuat të pronës / ndërtimeve të paligjshme kur është fjala për rastet e trashëgimisë.

Ka shumë zona që ka nevojë që të ndërmerren kampanja informuese. Në përgjithësi, njerëzit nuk e shihnin noterin si mundësi tek i cili qytetarët mund të fillonin procedurën e trashëgimisë. Kjo ishte mëse e vërtetë për të anketuarat femra, për serbët, dhe të anketuarit e grup moshave të rinjë dhe të vjetër.

Popullsia e moshës së re (18-24) ishin ai grup që më së paku kishte njohuri rreth këtyre çështjeve. Ata kishin më së shumti tendencë të identifikonin babain si person në krye të vendimeve, kontribuues të pasurisë, në krye të pronës, dhe si iniciator i procedurave të trashëgimisë. Ata, gjithashtu, kishin më së paku njohuri rreth dokumenteve të nevojshme për procedurat e trashëgimisë. Të gjithë të anketuarit identifikuan “vëllain” si më së paku mbështetës rreth trashëgimisë së femrave. Prandaj kjo statistikë mund të përdoret si informatë për të targetuar njerëzit e rinj, sidomos meshkujt e moshës së re, për t'i sensibilizuar dhe edukuar rreth të drejtave të femrave në pronë, sidomos për trashëgimi.

Në të njëjtën mënyrë, femrat kishin më pak njohuri se meshkujt lidhur me procedurat e trashëgimisë dhe të transaksioneve të tjera për bartjen e pronës. Si rezultat i kësaj, ato duhet të targetohen veçmas dhe më

intensivisht sesa meshkujt. Të anketuarit serbë kishin më pak njohuri se sa ata shqiptarë dhe të minoriteteve të tjera; prandaj ata duhet të targetohen në mënyrë të njëjtë, sidomos pasi që ata besonin më së paku se femrat duhet të trashëgojnë prej familjes së tyre të lindjes dhe dinin më së paku për raste kur vajza kishte trashëguar pronë.

Të gjitha të anketuarat femra, dhe të gjithë të anketuarit femra dhe meshkuj të nacionalitetit serb, më së paku prej grupeve tjera, identifikuan babain si sigurues të të ardhurave, dhe në anën tjetër identifikuan më së shumti nënën. Ky perceptim mund të ndikojë në ndërmarrjen e një kampanjë vetëdijësuese.

Këtu ka pasur shumë ndryshime regjionale gjithashtu të cilat mund të iniciojnë hulumtime të mëtutjeshëm dhe kampanja të ndryshme. Më konkretisht, banorët e regjionit të Ferizajt identifikuan baballarët dhe nënat si mbështetës të të drejtave pronësore dhe pajtoheshin më shumë se trashëgimia duhet të jetë e barabartë si për vajza ashtu edhe për djem. Anasjelltas, këta banorë dinin më pak për bartjet e trashëgimisë dhe të pasurisë së patundshme, kishin përqindjen më të ulët të të anketuarve të cilët konsideronin pronën e trashëguar si të tyre, dhe femrat kishin më shumë tendencë të deklaroronin se ato kishin hequr dorë nga të drejtat e tyre në trashëgimi. Kjo mund të iniciojë hulumtime të mëtutjeshme për të përcaktuar pse këto qëndrime janë më progresive, dhe ndoshta edhe një kampanjë tjetër vetëdijësuese.

Në Pejë, shumë më shumë të anketuar se sa mesatarja mbanin mend raste kur vajzat kishin trashëguar pronë. Gjithashtu, banorët e këtij regjioni kishin më shumë tendencë të raportonin një femër si pronare e regjistruar e pronës, dhe të identifikonin nënën si kontribuuese të pasurisë familjare. Megjithatë, këta persona pajtoheshin më së paku se trashëgimia mes djemve dhe vajzave duhet të ndahet në mënyrë të barabartë, se femrat duhet të trashëgojnë, dhe që vendimet familjare të merren bashkërisht mes gruas dhe burrit. Mungesa e njohurive ishte një ndër pengesat më të mëdha në këtë regjion. Hulumtimet shtesë mund të përcaktojnë nëse dhe pse femrat trashëgojnë më shumë në Pejë (dhe nga Gjakova e cila ka rezultate të njëjta) përkundër se qëndrimet faktike mund të influencojnë lloje tjera të programimit të aktiviteteve.

Në regjionin e Mitrovicës, njerëzit pajtoheshin më pak se sa në regjionet tjera, se femrat heqin dorë nga të drejtat e tyre në trashëgimi. Ky fakt mund të iniciojë ndonjë hulumtim shtesë për të përcaktuar arsyen e kësaj.

Gjithashtu, mund të iniciohet hulumtim i ndarë mes vendeve urbane dhe rurale. Prishtina dhe Peja patën më shumë pronësi të krijuar gjatë martesës, ndërsa në Prizren banorët posedonin në përgjithësi më pak pronë.

Përfundimisht, banorët e Prishtinës kishin më shumë njohuri rreth asaj se cila pronë duhet t'u takojë të dy bashkëshortëve. Jashtë Prishtinës, shumica e të anketuarve pajtoheshin se prona e krijuar gjatë martesës duhet t'u takojë të dyve, por më pak pajtoheshin se pronat tjera duhet t'u takojnë të dy bashkëshortëve. Kjo nënkupton se kampanjat duhet të fokusohen më shumë jashtë Prishtinës dhe në kategori të ndryshme të pronës; është gjithashtu e rëndësishme që të kuptohet dhe adresohet ndryshimi në perceptimin e llojeve të ndryshme të pronës.

**Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar**

1300 Pennsylvania Avenue, NW

Uashington DC 20523

Tel: (202) 712-0000

Fax: (202) 216-3524

**[www.usaid.gov](http://www.usaid.gov)**